

MINISTRI

Z. Arben Ahmetaj ka lindur në Gjirokastrë në vitin 1969. Ai është i martuar dhe ka dy vajza.

Mban titullin Doktor i Shkencave në fushën e Sigurisë energjitike, sigurisë ndërkombëtare, diplomuar në vitin 2009 në Universitetin e Bukureshtit në Rumani.

Ka kryer studimet Master në degën Tregti Ndërkombëtare dhe Diplomaci, në Universitetin e Kentucky-t në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, diplomuar në Dhjetor 1996. Në vitet 1996-2000, z. Ahmetaj ka kryer studimet në Universitetin George Washington, Departamenti i Ekonomisë, dega Menaxhimi i Politikave Ekonomike Publike dhe në Edmund Walsh School of Foreign Service, Washington, në degën Financë ndërkombëtare, tregjet financiare ndërkombëtare. Në vitin 1991 Z. Ahmetaj është diplomuar në Universitetin e Tiranës për Gjuhë Angleze, Specializuar në Literaturë Amerikane dhe Angleze.

Z. Ahmetaj është anëtar i Partisë Socialiste të Shqipërisë. Në vitin 2009 u zgjodh deputet në Kuvendin e Shqipërisë, duke përfaqësuar qarkun e Korçës dhe pas zgjedhjeve të vitit 2013, atë të Gjirokastrës. Ka qenë anëtar i Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Është anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste.

Në shtator 2013, Z. Arben Ahmetaj u emërua Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe nga Janari 2014, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Në vitet 1998-1999 ka mbajtur postin e Drejtorit të Përgjithshëm në Drejtorinë e Tatimeve të Shqipërisë. Në vitin 2003-2004 ka shërbyer si Zëvendës Ministër në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë ndërsa 2004- 2005, Zëvendës Ministër në Ministrinë e Integritimit Europian.

Në vitet '97-'98 ka punuar në Ministrinë e Financave me detyrën e Drejtorit të Kabinetit dhe ka qenë përgjegjës për marrëdhëniet Ndërkombëtare, anëtar i grupit që ka marrë pjesë dhe koordinuar negociatat me Fondin Monetar dhe që konkretizoi një marrëveshje post konfliktuale me ESAF.

Ndër eksperiencat e tjera profesionale janë edhe detyra si Këshilltar për çështjet Fiskale në Bankën Amerikane të Shqipërisë; Janar-Qershor '99; Këshilltar për Çështjet Fiskale në Bankën e Shqipërisë; eksperiencia e punës pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar gjatë periudhës nëntor '93- shkurt '95.

Nga 18 Shkurti 2016, Z. Arben Ahmetaj mban detyrën e Ministrit të Financave të Republikës së Shqipërisë.

ZV/MINISTRI

Z.Luçi mban gradën Doktor (Phd) nga Universiteti Stadffordshire në Angli, (1999-2002), ku ka mbrojtur dizertacionin me titull "Ndërmjetësi Financiar në vendet në Tranzicion me fokus Shqipërinë". Në po të njëjtin universitet, ai ka marrë gradën Master në Ekonomiks gjatë periudhës 1997-1999.

Z.Luçi ka përfunduar studimet e larta në Ekonomiks, pranë Universitetit të Tiranës, ku është vlerësuar me medaljen "Student i Shkëlqyer". Ka mbajtur pozicionin e drejtorit të Departamentit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë (2003-2006) dhe pedagog i jashtëm pranë Departamentit të Ekonomiksit, në Fakultetin Ekonomik, në Universitetin e Tiranës (1996-2013). Në muajin Tetor është emëruar zëvendësministër i Financave, përgjegjës për sektorin Makro dhe Shpenzimet Fiskale.

Alba Çaroshi

Këshilltare e Ministrit të Financave

Alba Çaroshi është diplomuar për Ekonomiks në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Ajo mban titullin Master për Studime Europiane, me specializim për “Politikat Ekonomike Publike dhe Qeverisja e Bashkimit European”, pranë Institutit të Studimeve Europiane.

Ka marrë pjesë në një sërë projektesh studimi të lidhura me “Menaxhimin e Krizave”, “Mbrojtja e konkurrencës në tregje” “Menaxhimi i burimeve njerëzore si instrument konkurrueshmërie në kushtet e Globalizmit”; “Komunikimi i Organizatave”; “Sfidat Ekonomike dhe politike të BE-së” etj.

Znj. Çaroshi ka punuar në sektorin bankar si Drejtuese e Zyrës së Bankingut Privat.

Ajo zotëron shumë mirë gjuhët angleze, italiane dhe greke.

Knidi Bashari

Këshilltar i Ministrit të Financave

Z.Knidi Bashari është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Ka ndjekur programin dy vjeçar të Masterit të Administrimit Publik në programin e përbashkët që Universiteti i Tiranës ka me Universitetin e Nebraskës (USA) dhe mban titullin Master në Administrim Publik.

Z Bashari ka një esperiencë disa vjeçare në administratën publike ku ka shërbyer si këshillat i kabinetit të Ministrit të Financave për institucionet ndërkombëtare dhe politikat fiskale.

Për dy vite ka mbajtur funksionin e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë në Organizatën SECI me seli në Bukuresht Rumani, ku ka kryesuar Taks – Forcën Ballkanike në Qendren SECI.

Për një periudhë të shkurtër ka shërbyer si këshillat në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, (Albinvest) duke ndihmuar në riorganizimin dhe hartimin e dokumentave strategjike të kësaj agjencie për nxitjen e investimeve të huaja në Shqipëri, me ndihmën e projekteve të asistencës së Bankës Botërore.

Gjithashtu Z. Bashari ka njohuri dhe një esperiencë të gjerë në menaxhimin e projekteve në fushën e biznesit dhe ka shërbyer si konsulent në realizimin e shumë projekteve brenda dhe jashtë vendit.

Ai zotëron gjuhën angleze, dhe italiane.

Gjergji Kosta

Këshilltar i Ministrit të Financave

Gjergji Kosta është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Ka ndjekur programin dy vjeçar të Masterit të Nivelit të Dytë për Shkenca Juridike Civile në këtë fakultet, si dhe ka kryer një sërë trajnimesh pasuniversitare në fushën e të drejtës tregtare.

Z.Kosta ka një eksperiencë prej më shumë se 13 vjeçare në administratën publike dhe gjatë karrierës së tij ka kryer funksione të rëndësishme në Ministrinë e Ekonomisë dhe jo vetëm. Ka mbajtur funksionin e Drejtorit të Kabinetit të Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës; funksionin e Këshilltarit Juridik të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, si dhe të Këshilltarit Juridik të Ministrit të Privatizimit;

funksionin e Drejtorit të Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Ekonomisë; funksionin e Drejtorit Juridik në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Palujatshme.

Gjithashtu Z.Kosta ka qenë konsulent ligjor i projekteve të ndryshme të financuara nga Banka Botërore, Agjencia Gjermane për Bashkëpunimin Teknik (GTZ) etj.

Ai zotëron gjuhën angleze

Gelardina Prodani
Sekretar i Përgjithshëm

Mban titullin Master në Studimet Ekonomike Europiane nga Universiteti i Tiranës dhe ai i Bambergut, si dhe ka marrë gradën Master në Politikat Ekonomike nga Williams College, MA, SHBA, një nga kolegjet më të mira amerikane për Artet Liberale i radhitur në 15 vitet e fundit. Ndërkohë po punon për marrjen e gradës së Doktoraturës në “Politika Ekonomike”. Që prej vitit 2012 mban pozicionin e Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Buxhetimit në networkun e mësimit të praktikës të menaxhimit të shpenzimeve publike (PEMPAL), network i përbërë nga drejtorë të buxhetit të 22 vendeve të Europës Lindore dhe Qendrore dhe Azisë Qendrore koordinuar nga Banka Botërore, Qeveria Zvicerane, OECD, GIZ dhe Federata Ruse. Nga vitet 2005 – 2013 ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Buxhetit/ Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave. Ka punuar si Asistent Pedagoge në nivelin bachelor pranë Fakultetit Ekonomik, të Universitetit të Tiranës (1998-2009), ndërkohë është pedagoge në nivelin master pranë Universitetit Europian të Tiranës. Pas 15 vitesh eksperiencë në Ministrinë e Financave, znj.Prodani së fundmi është emëruar Sekretare e Përgjithshme, tetor 2013.